



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2020:071305

Datë: 26.11.2024

Numri i dokumentit: 06506207

C.nr.416/2020

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA DEÇAN, Departamenti I përgjithshëm civilë e shkallës së parë me gjyqtarin Bekim Avdimetaj në kontestin e paditësës B. K. S, të cilin më autorzim e ka përfaqësuar G.A. nga P., kunder te paditurit H. (A.) Sh. me pare nga fshati D. K. e D. tani me adres te pa njohur qe ka perfaqesuar perfaqesuesi i perkoshem avokati H. B. nga D. për rimbursim dëmit, vlera e kontestit në shumën prej 5180.00 euro, gjykata pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesorë publike më datën 07.11.2024 në prani të përfaqësueses të paditësës, përfaqësuesit të perkoshem te paditurit te perpiluar me daten 21.11.2024 mur këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET në tersi si e bazuar kërkesëpadia e paditësës B. K. e S., të cilin më autorzim e ka përfaqësuar G. A. nga P.

II.DETYROHET, i padituri H.(A).SH nga fshati D. K.D, qe paditësës B.K e S., te ja rimburoj shumën 5.180.00 euro, për aksidentin e shkakuar në trafik më datën 22.06.2017 rrethe orës 16:00 në fshatin Z. K.e me kamat prej 8% nga dita e paraqitjes te padis ne gjykate me datën 10.06.2020, e deri ne pagesën definitive, të gjitha këto të paguhen në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes te këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit.

III.DETYROHET paditësja B.K e S. (,qe përfaqësuesit te perkoshem te paditurit avokatit H. B. nga D., te ja paguan shumën prej 270.40 euro, në xhirollogarinë e tij bankarë me numër 1403000033773636 në Bankën Ekonomike, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes te këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja B.K e S., të cilin më autorzim e ka përfaqësuar G. A. nga P. ka paraqitur padi ne kete gjykate me daten 10.06.2020,kunder te paditurit H.(A).SH me pare nga fshati D. K.D, tani me adres te pa njohur qe ka perfaqesuar perfaqesuesi I perkoshem avokati H. B. nga D. për rimbursim dëmit, vlera e kontestit në shumën prej 5180.00 euro

Juridiksioni dhe kompetenca e gjykatës

Neni 37 par .1 i Ligjit të Procedurës Kontestimore parashihet, nëse me ligj nuk është caktuar kompetenca ekskluzive territoriale e ndonjë gjykate tjetër, për procedimin e çështjes është kompetente gjykata e kompetencës së përgjithshme për palën e paditur.

Pretendimet e paleve dhe perfaqesuesve gjate seances shqyrtimit kryesore

Përfaqësuesja e paditëses G.A. gjate seancës te shqyrtimit përgatitorë dhe kryesorë ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së sajë. Nga provat e bashkangjitura me padi vërtetohet se i padituri në ditën e aksidentit me datë 22.06.2017. Përpos që nuk kishte mbulesë siguroese, i njëjti me veprimin e tij të kundërligjshëm godet veturën “B “ me ç ‘rast shkaktonte aksident me dëme materialë dhe jo materialë. Përkitazi me këto dëme të shkaktuara palët e dëmtuara kishin paraqitur kërkesë për kompensim tek tani paditësja ashtu që, të dëmtuarve në fjalë u ishte kompensuar shuma në vlerë prej 5,100.80 euro ku këto mjete më pas ishin transferuar në llogarit e të dëmtuarve. Tani në këtë fazë kërkojmë nga i padituri që komform LSDA-së dhe LMD-së, rimbursimin e dëmit të shkaktuar, kërkesë kjo e cila bazohet edhe me Aktgjykimin Penal me shenjë P.nr.32/18 të GJTH Pejë – Dega në Klinë, i datës 13.09.2018, me të cilin i njëjti është shpallur fajtorë.

Paditëse me parashtresën dorëzuar gjykatës me shkrim me date 02.04.2024 ne pa mundësi qe ta sigurojmë adresën e te paditurit ti caktohet një përfaqësues i përkohshëm për përfaqësim ne seanca .Gjykata jashtë seance e ka aprovuar propozimin e padisës dhe me aktvendimi te kësaj gjykate me numër C.nr.416/20, i datë 01.07.2024, të paditurit i është caktuar përfaqësuesi i përkohshëm dhe nga zyra Regjionale Avokatëve në Pejë kanë caktuar avokatin H. B. nga D.. I cili aktvendim i lartshënuar është përkthyer edhe në gjuhën Serbë dhe është publikuar në gazetën zyrtare te Republikës se Kosovës.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit avokati H. B. nga D. gjate seancës te shqyrtimit kryesore me date 07.11.2024 dhe ne fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar fillimisht njoftoj gjykatën se me parashtresë të dorëzuar nga përfaqësuesja e paditëses. I kam pranuar shkresat e lëndës dhe sa i përket padisë dhe kërkesës së saj. Në parim e kundërshtojmë padinë dhe kërkesën e saj. Ngase konsiderojmë se është kërkesë e pa bazuar dhe përkundër përpjekjeve që të bie në kontakt me të paditurin H. Sh., mirëpo gjitha këto pa një rezultat. Andaj nga pozicioni im si përfaqësues i përkohshëm i palës së paditur ndihem i rezervuar që të pohoj diçka lidhur me këtë çështje për çka i lëmë gjykatës në vlerësim dhe vendosje.

Administrimi i provave gjate seancës te shqyrtimit kryesore

- Lexohet padia e dorëzuar në gjykatë nga paditësja me datë 10.06.2020,
- Lexohet parashtresa e paditëses dorëzuar në gjykatë me shkrim me datë 02.04.2024, që të paditurit t’i caktohet një përfaqësues i përkohshëm nga ana e gjykatës,
- Lexohet aktvendimi i kësaj gjykate me numër C.nr.416/20, i datë 01.07.2024, që të paditurit i është caktuar përfaqësuesi i përkohshëm dhe nga Zyra Regjionale kanë caktuar avokatin H. B. nga D., i përkthyer dhe në gjuhën Serbë dhe i njëjti është publikuar në gazetën zyrtare,
- Lexohet Aktgjykimi penal i marr në GJTH – Pejë, Dega Klina me numër P.nr.32/18, të datës 04.09.2018,
- Lexohet parashtresa e paditëses për dorëzimin e provave e dorëzuar në gjykatë me datë 27.09.2024,

- Lexohet fletë transferim i paditëses i bërë ndaj avokatit R.H. për kompensimi të familjes H. dhe familjes Th. me shumën prej 5.180 Euro me datë 12.11.2018,
- Lexohet procesverbali mbi shqyrtimin kryesor i mbajtur në Gjykatën Themelore në Gjakovë – Dega Rahove me datë 30.10.2018, ku është bërë pajtim gjyqësor në mes të paditëses dhe të paditurit, për kompensimin e të gjitha formave të dëmeve material dhe jo materiale.
- Lexohet raporti i aksidentit i kryer nga policia me numër DR.3009 – 05, i datës 22.06.2017,
- Lexohet raporti i emergjencës i Spitalit Rajonal “ Isa Grezda” me numër 7613, në emër të K. (H.) Th., i datës 22.06.2017,
- Lexohet raporti i emergjencës i Spitalit Rajonal “ Isa Grezda” me numër 7617, në emër të F. (M.) Th., i datës 22.06.2017,
- Lexohet raporti i emergjencës i Spitalit Rajonal “ Isa Grezda” me numër 7616, në emër të J. (S.) H., i datës 22.06.2017,
- Lexohet raporti i emergjencës i Spitalit Rajonal “ Isa Grezda” me numër 7614, në emër të H. (M.) Th., i datës 22.06.2017,
- Lexohet raporti i emergjencës i Spitalit Rajonal “ Isa Grezda” me numër 7615, në emër të Q. (H.) Th., i datës 22.06.2017,
- Lexohet fletë lëshimi i lëshuar nga Reparti Kirurgjikë – Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, me numër të historisë 793, në emër të Q. (H.) Th.,
- Lexohen raportet mjekësore të datës 27.06.2017, 30.07.2017 në emër të Q. (H.) Th.
- Lexohen raportet mjekësore të lëshuara nga QKMF-ja me numër 004736, në emër të J. (S.) H., me numër 052397, të datës 23.06.2017,
- Lexohen pagesat dhe kopjet e kuponëve të paguara për medikamente të blera, të lëshuara nga Spitali regional në Gjakovë me numër 025840, në emër të Q. (H.) Th.,
- Lexohet konfirmimi i sigurimit i lëshuar nga paditësja me numër TPL5853019, i datës 08.09.2017, ku i siguruar ka qenë H. N., në automjetin me numër....., markë 207 “P...”,
- Lexohet ekspertiza e dhënë e komunikacionit e nxjerrë me kërkesë të Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshme, me numër të lëndës PP/II.nr.1740/17, e kryer nga eksperti S.B.

Te cilave fakteve te lartshënuar qe gjenden ne shkresat e lendes gjykata ja ka falur besimin

Përfaqësuesja e paditëses e lartshënuar në fjalën e sajë përfundimtarë ka deklaruar se nga administrimi i provave konsiderojmë se është arsyetuar dhe vërtetuar mjaftueshëm përgjegjësia e të paditurit karshi dëmit të shkaktuar të aksidentit të datës 22.06.2017. Ku nga ky aksident B.K.S. përmes fondit të kompensimit ka kompensuar të dëmtuarin, andaj për këtë i propozoj

gjykatës që ta aprovojë në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të bazuar. Ashtu që ta obligoj të paditurin që ta kthejë borxhin në emër të rimbursimit të dëmit si dhe shpenzimet e procedurës. Të gjitha këto me kamatë ligjorë nga dita e ngritjes së kësaj padie e deri në ditën e pagesës përfundimtarë, si dhe shpenzimet gjyqësore të cilat do i caktojë gjykata bazuar në nenit 18 pika 4 të LSDA-së.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit i lartshënuar në fjalën e tij përfundimtarë ka deklaruar qëndrojmë pranë deklarimeve dhe kundërshtimeve të cekur asi më lartë ashtu që. Për vendosjen e kësaj çështje dhe vlerësim të provave të administrua mbetet që gjykata të vendosë me aprovim apo refuzim të kësaj çështje. Sa i përket shpenzimeve gjyqësore. Të njëjtat i kërkojmë sipas tarifës së OAK-së, dhe këtë për dy seanca për secilën nga 135.20 euro, në xhirrollogarinë bankarë me numër..... në Bankën Ekonomike.

Baza juridike e kërkespadis të padises gjen mbështetje të Neni 18. Dëmshpërblimi nga përdorimi i mjetit motorik të pasiguar par 4. B. ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat. të ligjit Nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrues nga autopërgjegjesia. Ndërsa më nenin 136 par. 1 kush I shkaton tjetrit dem ka për detyrë ta kompensoj, përveç nese vertetohet se dem është shkaktuar pa fajin e tij, Neni 140 Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia. të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve të Republikës së Kosovës .

Dispozitat ligjore

Gjykata duke çmuar me kujdes çdo provë veç e veç dhe ato ne lidhshmeri njera me tjetren dhe nga kjo gjendje e vërtetuar faktike si më lartë, erdhi ne përfundim dhe vërtetoj ne mënyrë te pa dyshimte kërkesëpadia e padisës në tersi është e bazuar nenet 18. Dëmshpërblimi nga përdorimi i mjetit motorik të pasiguar par 4. B. ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat. të ligjit Nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrues nga autopërgjegjesia, nenit 8,34, 106, 136,140,159,169,183 te Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, të Republikës së Kosovës duke vendosur si ne piken I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimin që e paditësja përfaqësuesit te përkohshëm te paditurit avokatit H. B. si ne piken III te dispozitivit te këtij aktgjykimi te ja paguan për përfaqësim te paditurit për 2 (dy) seanca gjyqësore 2x135.20 euro ne shumen prej 270.40 euro, në xhirrollogarinë e tij bankarë me numër..... në Bankën Ekonomike, gjykata e mbështeti në dispozitat e nenit 449 par.1,2 463 par.1, 2 të LPK-së,

Nga sa u tha me lartë u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

NGA GJYKATA THEMELORE PEJË- DEGA NË DEÇAN.

GJYQTARI
Bekim Avdimetaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa ne afat prej 15 ditësh Gjykatës së Apelit ne Prishtinë e përmes kësaj gjykate.